

V E N D I M
Nr. 272, datë 10.6.1999

**PËR IMPORTIMIN, TRANZITIMIN DHE MAGAZINIMIN E DUHANEVE DHE TË
PRODUKTEVE TË HUAJA TË DUHANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e këtij vendimi, i cili rregullon importimin, tranzitimin dhe magazinimin e duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit, mbështetur edhe në dispozitat e Kodit Doganor dhe në dispozitat zbatuese të tij.

2. Për qëllim të këtij vendimi termat e përdorura kanë kuptimin si vijon:

a) Administratë doganore do të thotë zyrat, qendrore dhe lokale, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

b) Kod doganor do të thotë Kodi doganor, i miratuar me ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999, si dhe dispozitat zbatuese të tij;

c) Dispozita zbatuese të Kodit Doganor do të thotë dispozitat e miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4.1999;

ç) Administrues i autorizuar është personi përgjegjës për administrimin e magazinës doganore dhe fiskale;

d) Magazinë doganore dhe fiskale quhet impianti ose magazina, ku duhanet dhe produktet e huaja të duhanit magazinohen, nën një regjim pezullimi nga detyrimet e importit, me përjashtim të akcizës, sipas procedurave të përcaktuara nga Kodi Doganor;

e) Detyrimet e importit nënkupton taksat doganore si dhe tatime e taksa të tjera, të vendosura me ligj, që paguhen për importimin e duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit, duke përjashtuar akcizën;

ë) Regjim pezullues do të thotë regjimi që zbatohet për magazinimin dhe qarkullimin e duhaneve dhe të produkteve të huaja, të duhanit deri në çastin e vjeljes së detyrimeve doganore të importit, duke përjashtuar akcizën;

f) Produkte duhani do të thotë:

- cigare dhe cigare puro
- duhan për pirje

g) Duhane do të thotë produkte me prejardhje nga çfarëdolloj bime, e cila, nga pikëpamja botanike, klasifikohen si «nikotinë», substanca të përgatitura, të përshtatshme për të zëvendësuar duhanin për pirje ose për nuhatje, si dhe çdo lloj produkti, të përbërë pjesërisht nga duhan i papërpunuar ose i përpunuar, që mund të pihet, përthypet ose nuhatet dhe që nuk ka ndonjë funksion të veçantë mjekësor;

gj) Duhane e produkte të huaja duhani do të thotë produkte të përkufizuara në shkronjat «f» dhe «g», të cilat kanë statusin doganor të «mallrave joshqiptare».

h) Territor doganor shqiptar quhet territori tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësira ajrore e Republikës së Shqipërisë.

3. Detyrimet e importit për duhanet dhe produktet e huaja të duhanit paguhen në çastin e importimit, në mbyllje të regjimit pezullues, sipas procedurave të përcaktuara nga Kodi doganor.

4. Tranzitimi i duhaneve dhe i produkteve të huaja të duhanit në brendësi të territorit doganor shqiptar lejohet të kryhet për qëllime të dërgimit të tyre në magazinat doganore, fiskale, nga personat e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe vetëm në rrugët që të çojnë drejtpësdrejt në magazinën e autorizuar, doganore e fiskale. Çdo tranzitim tjetër i duhaneve dhe i produkteve të huaja të duhanit derivate të tij nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë është i ndaluar dhe ndëshkohet me dënime të parashikuara për krimin e kontrabandës.

5. Importimi i duhaneve dhe i produkteve të huaja të duhanit të kryhet vetëm pranë zyrave doganore të hyrjes në territorin doganor shqiptar.

6. Qarkullimi brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, i duhaneve dhe i produkteve të huaja të duhanit, të importuara lejohet vetëm nëse mbi çdo paketë apo njësi të importuar është vendosur pulla fiskale, konform akteve ligjore.

7. Autorizimi për administrimin e magazinave doganore e fiskale për magazinimin e duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas rregullave të parashikuara në Kodin Doganor.

8. Numri maksimal i magazinave doganore dhe fiskale për magazinimin e duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit, që mund të autorizohen njëkohësisht, përcaktohet nga ministri i Financave.

9. Personi i interesuar për administrimin e një magazine doganore dhe fiskale duhet t'u paraqesë një kërkesë të veçantë zyrave kompetente në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, ku duhet të tregohen:

a) emri dhe adresa e personit kërkues dhe emri i përfaqësuesit të ligjshëm, në rastin e një shoqërie;

b) vendndodhja e lokaleve, që do të përdoren për magazina;

c) emri i personit përgjegjës për administrimin e magazinave, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

shtetësi shqiptare;

aftësi të plotë për të vepruar sipas legjislacionit shqiptar;

moshë mbi 18 vjeç;

të mos jetë proceduar ndonjëherë, nga pikëpamja administrative dhe penale, për shkelje të ligjeve doganore dhe fiskale, shqiptare;

të mos jetë dënuar penalisht, çka duhet vërtetuar me dokumentet përkatëse.

ç) kodin fiskal dhe NIPT-in e regjistrimit në sektorin e TVSH-së, pranë zyrave të tatimeve;

d) sasinë maksimale të duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit, që mund të depozitohet në magazinë

10. Së bashku me kërkesën duhet të paraqiten të gjitha dokumentet e nevojshme për shqyrtimin e saj, ndër të cilat edhe:

a) planimetria e lokaleve, që do të përdoren si magazinë, qofshin këto pronë e shoqërisë (subjektit), apo të mara me një kontratë qiraje;

b) një garanci bankare si kërkesë, absolutisht, parësore, masa e së cilës përcaktohet në pikën 16;

c) një raport mbi sasinë e duhanëve dhe të produkteve të huaja të duhanit, që do të futen çdo vit në magazinë.

Mungesa ose pasaktësia e cilitdo nga treguesit apo e dokumenteve të lartpërmendura sjell refuzimin e menjëhershëm të kërkesës.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave regjistron të gjitha kërkesat, në një regjistër të posaçëm, të hapur për publikun, së bashku me të gjithë dokumentacionin e sipërpërmendur, sipas radhës kronologjike, në përputhje me datën e paraqitjes dhe vlerëson pranueshmërinë e tyre mbi bazën e të gjitha kushteve të lartpërmendura, duke marrë parasysh kufizimin e caktuar në pikën 8. Duke iu referuar edhe një herë kufizimit të bërë në pikën 8, kërkuesit, që kanë kryer importe duhanesh dhe produktesh të huaja duhani gjatë vitit 1998, e që i plotësojnë kërkesat e shtrura më lart, në këtë nen, trajtohen me përparësi në krahasim me të tjerët.

12. Në rast refuzimi të kërkesës mund të bëhet ankim, sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara në Kodin doganor.

13. Lokalet e caktuara si magazinë doganore dhe fiskale për duhanet dhe produktet e huaja të duhanit duhet të ofrojnë garancitë e duhura për funksionimin dhe sigurinë, si dhe kapaciteti tyre duhet të jetë në përputhje me sasinë e produkteve që do të magazinohen.

14. Në lokalet e caktuara si magazina doganore dhe fiskale për duhanet dhe produktet e huaja të duhanit nuk mund të futen, të magazinohen ose të ruhen mallra dhe produkte të një lloji tjetër, qofshin këto mallra shqiptare ose joshqiptare.

15. Brenda magazinave ndalohet të kryhet çdo operacion trajtimi, transformimi ose ndryshimi i produkteve të magazinuara, çka nënkupton vetëm kryerjen e veprimeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e tyre.

16. Magazinuesi i autorizuar është i detyruar t'i japë Drejtorisë së Përgjithshme Doganore, në kohën e paraqitjes së kërkesës, një garanci bankare, si kërkesë absolutisht parësore, të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë, e regjistruar në Shqipëri, për një shumë jo më të vogël se 50 për qind e shumës së përgjithshme të detyrimeve të importit që duhet paguar për sasinë maksimale të duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit, që mund të ruhen në magazinë, sikundër është përcaktuar nga zyra kompetente e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Një garanci e tillë duhet të ketë të njëjtën kohëzgjatje si edhe autorizimi.

17. Futja e duhaneve dhe e produkteve të huaja të duhanit në magazinën doganore fiskale kryhet nëpërmjet paraqitjes pranë zyrës doganore, që është kompetente për territorin ku është vendosur magazina, të deklaratës për vendosjen e mallrave në regjimin e magazinimit doganor, në përputhje me Kodin doganor.

18. Administruesi i autorizuar është përgjegjës jo vetëm për shkeljet fiskale, që ndodhin gjatë magazinimit të duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit, të futura nga ai në magazinën doganore dhe fiskale, por edhe për gjithçka që ndodh gjatë transportimit të tyre, nga pika doganore deri në magazinë.

19. Administruesi i autorizuar është i detyruar të respektojë të gjitha rregullat, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me dokumentacionin kontabël ose atë shoqërues, dhe të lejojë çdo kontroll të ligjshëm, nëpërmjet inspektimeve të magazinës nga administrata doganore dhe ajo tatimore.

20. Administruesi i autorizuar është i detyruar të mbajë një regjistër të posaçëm për hyrjet dhe daljet e produkteve të magazinuara apo të qarkulluara nëpërmjet magazinës doganore fiskale, sipas modelit të caktuar nga administrata fiskale, në të cilën duhet të tregohen:

A. Në hyrje:

- a) Data e futjes së duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit në magazinë;
- b) Sasia e depozituar për çdo lloj produkti, e cila duhet të korrespondojë me sasinë që del, në bazë të dokumenteve përkatëse për çdo operacion dërgimi ose edhe me sasinë e treguar në deklaratat doganore të vendosjes së mallrave në regjimin e magazinimit doganor;
- c) Numri i deklaratës doganore të vendosjes së mallrave në regjimin e magazinimit doganor;
- ç) Ekstremitetet identifikuese të mjetit të transportit, me të cilën transportohet malli;
- d) Shuma e përgjithshme e detyrimeve të importit të vendosura për mallin.

B. Në dalje:

- a) Data e daljes së mallit nga magazina;
- b) Sasia e nxjerrë nga magazina, e cila duhet të përputhet me sasinë e treguar në deklaratën doganore të vendosjes së mallrave në qarkullim të lirë;
- c) Numri i deklaratës doganore të vendosjes së mallrave në qarkullim të lirë;
- ç) Ekstremitetet identifikuese të mjetit të transportit, me të cilin transportohet malli;
- d) Shuma e përgjithshme e detyrimeve të paguara për mallrat e vendosura në qarkullim të lirë.

Regjistrin të hyrjeve dhe të daljeve duhet t'i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni justifikues, që vërteton saktësinë e të gjitha të dhënave që janë shkruar në regjistër.

21. Autorizimi për administrimin e magazinave doganore, fiskale revokohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në rastet kur:

a) Shkelen një ose më shumë dispozita, që lidhen me importimin dhe transportimin e duhaneve dhe të produkteve të huaja të duhanit, qofshin këto të përcaktuara edhe në ligje të tjera ose në akte të tjera nënligjore;

b) nuk plotësohen një ose më shumë kërkesa të treguara në pikat 9 dhe 10 të vendimit.

22. Kundër masës së revokimit të autorizimit mund të bëhet ankim, sipas mënyrës

dhe afateve të përcaktuara në Kodin doganor.

23. Të gjitha vendimet dhe udhëzimet, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko